

## NJOFTIM PUNËSIMI

### Prezantimi i Shoqërisë Rajonale UK

Sh.a. Ujësjiellës Kanalizime Rajoni Durrës është themeluar më 31.08.2022 sipas VKM nr. 302, dt. 11.05.2022 “Për Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”. Shoqëria Rajonale UK është një institucion profesional i licencuar për ofrimin e shërbimeve bazike të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve. Ajo i shërben bashkisë Durrës, Shijak, Kavajë, Rrogozhinë dhe Krujë.

Aktualisht Shoqëria Rajonale UK po kërkon të punësoj për një vend pune: Topograf/e pranë Sektorit të Menaxhimit të Aseteve në Drejtorinë e Planifikimit dhe Menaxhimit të Aseteve nisur nga data më e afërt.

Punëmarrësi i ri do të jetë përgjegjës për kryerjen në kohë e me cilësi të të gjitha matjeve topografike që i shërbejnë Sektorit dhe Drejtorisë në këto zëra:

- a. Për hartimin e projekteve.
- b. Për zgjidhje teknike të ndryshme që çojnë në përmirësimin e funksionimit të rrjetit Ujësjiellës-Kanalizime mbi bazën e kërkesave të ndryshme dhe nevojave të reparteve.

### Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

- Përgatit skica, harta, raporte, përshkrime ligjore, të vëzhgimeve të ndryshme që të mund të përshkruajë ashtu sikurse dhe të marrë përgjegjësi për punën e kryer.
- Regjistron rezultatet e vëzhgimeve, duke përfshirë formën, vendndodhjen, lartësinë dhe dimensionet e tipareve të tokës.
- Llogarit lartësinë, thellësinë, pozicionet relative, kufijtë e pronave dhe karakteristikat e tjera të terrenit.
- Verifikon saktësinë e të dhënave të matura, duke përfshirë matjet dhe llogaritjet gjatë vëzhgimeve.
- Përgatit dhe monitoron përgatitjen e të gjitha të dhënave grafike, hartat e regjistrimeve dhe dokumente që kanë të bëjnë me vëzhgimet.
- Mban përgjegjësi të drejtpërdrejtë për të gjitha matjet topografike që i shërbejnë Shoqërisë për hartimin e projekteve.
- Mban përgjegjësi të drejtpërdrejtë për azhurnimin faktik të pikave të lidhjes.
- Angazhohet në funksion të Sektorit të Projektimit dhe Planifikimit Strategjik sipas nevojës, për hartimin e projekteve apo çdo nevojë për specialitetin që ka si topograf.

<b>Kualifikimet e synuara dhe dokumentacioni:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Eksperienca pune të mëparshme.</li> <li>• Librezë e Punës</li> <li>• Certifikatë Familjare</li> <li>• Fotokopje e Kartës së Identitetit, Pasaportës</li> <li>• Dy fotografi</li> <li>• Fotokopje e Diplomës me listën e notave e noterizuar</li> <li>• Dëshmi Penaliteti</li> <li>• Raporti Mjekësor</li> <li>• Vërtetim Vendbanimi</li> </ul>
<b>Kushtet e punës:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mundësinë për të punuar në një kompani të ngritur.</li> <li>• Mundësinë për të krijuar eksperiencë në kompani.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nëse jeni të interesuar dhe besoni se ju përmbushni të gjitha kërkesat për pozicionin e punës, ju lutemi aplikoni me letër përcjellëse, CV-në dhe dëshmi të kualifikimeve arsimore dhe profesionale (diplomë, certifikata, etj.) deri më datë 13.05.2026, pranë Protokollit të Dr.Përgjithshme Shoqërisë UK.Rajoni Durrës. Për çdo pyetje/paqartësi, ju lutemi kontaktoni në emailin zyrtar.</li> </ul>	